**VENDIM**
**Nr. 143, datë 22.2.2017**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "RIJETËSIMI I QENDRËS SË QYTETIT DELVINË"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", ligjit nr.160/2014, "Për buxhetin e vitit 2015", të ndryshuar, dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rijetësimi i qendrës së qytetit Delvinë".

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Delvinë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë "tokë truall" dhe "objekt", me një vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 10 719 236 (dhjetë milionë e shtatëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e dyqind e tridhjetë e gjashtë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 10 719 236 (dhjetë milionë e shtatëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e dyqind e tridhjetë e gjashtë) lekësh, të përballohet nga llogaria "Fondi i shpronësimeve", në Bankën e Shqipërisë. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2017, miratuar për Ministrinë e Zhvillimit Urban.

5. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në "Fletoren zyrtare".

6. Pronarët e listës që i bashkëlidhet këtij vendimi të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Bashkisë Delvinë.

7. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Sarandë, brenda 30 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Delvinë, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit në hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjnë kalimin e pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.

8. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Sarandë të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin që do të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit në hartën kadastrale si dhe kalimi i pronësisë, për pasuritë e shpronësuara.

9. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Zhvillimit Urban, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Sarandë dhe Bashkia Delvinë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Edi Rama**

**TABELA E PASURIVE QE SHPRONESOHEN TE CILAT PREKEN NGA ZBATIMI I PROJEKTIT"RIJETËSIMI I QENDRËS SË QYTETIT DELVINË"**

| Nr. | Pronari | | Zona Kadastrale | Nr. Pasurisë | Lloji i ndërtimit | Sipërfaqe | | Çmimi | | Vlera | | Shënime |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Emri | Mbiemri | | | | Truall m² | Ndërtim m² | Truall lekë | Ndërtim lekë | Truall lekë | Ndërtim lekë | |
| | | | | | | | | | | | | |
| 1 | NDUE | KODRA | 1464 | 6 47 | Tregti | 200 | 120 | 1587 | preventiv | **317.400** | **6,551,967** | **Barrë hipotekore** |
| 2 | VANGJEL | BARZUKA | 1464 | 6 47 | Tregëti | 0 | 120 | | preventiv | | **3.849.869** | **Konfirmuar nga ZVRPP** |
| | | | | | | | | | | | | |
| | **Shuma** | | | | | | | | | **317.400** | **10.401.836** | |
| | | | | | | | | | | | | |
| | **VLERA TOTALE** | | | | | | | | | | **10.719.236** | |

**Shënim: Vlerësimi i objekteve është kryer sipas VKM nr.138, datë 23.03.200 dhe vlerësimi i truallit është 1587 lek/m2 sipas VKM-së nr.89' datë 3.2.2016.**